

Nr.	Rreziku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të rrezikut	Prioriteti	Kontrolli (rekomandime)	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati për realizimin e aktiviteteve
OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE FORCIMI I KAPACITETEVE NJERËZORE NË LIDHJE ME ETIKËN DHE INTEGRITETIN					
1	Mangësi në strukture të pozicioneve të rëndësishme si Specialist IT apo Inxhinier Biomjekësor	Veprimtaria	I lartë	1. Propozim në MSHMS për ristrukturim të strukturës së QKTGJ për shtimin e pozicionit Specialist IT apo Inxhinier Biomjekësor	Spektori i Burimeve Njerëzore, MSHMS. Gjashtëmujori i parë, 2024
2	Vonesa në realizimin e detyrave, fluks i shtuar pune, që rrit riskun e gabimeve për shkak të nevojës për shtim të personelit mjekësor	Veprimtaria	I lartë	1. Propozim në MSHMS për ristrukturim të strukturës së QKTGJ për shtim të personelit mjekësor	Spektori i Burimeve Njerëzore, MSHMS. Gjashtëmujori i parë, 2024
3	Informacion i kufizuar i punonjësve për rregulloren e Konfliktit të Interesave (KI) të QKTGJ, të drejtën për informim dhe kufizimet e saj, të dhënat personale si edhe informacione e klasifikuara, konfidenciale	Burimet Njerëzore/ Reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	1. Të planifikohen takime periodike me punonjës të QKTGJ për njohjen e rregullores së KI-së dhe sigurinë e të dhënave personale.	Spektori i Burimeve Njerëzore. Në vijimësi, çdo vit si dhe çdo herë që punësohet një punonjës i ri
4	Përshkrimet e vendeve të punës nuk reflektojnë plotësisht detyrat shitesë	Veprimtaria	Mesatar	1. Rishikimi i përshkrimeve të vendeve të punës. Përfshirja e detyrave të reja në përshkrimet e punës	Përgjegjësit e çdo sektori, Menaxheri i Cilësisë, Përgjegjësi i burimeve njerëzore. Gjashtëmujori i parë i 2024

PLANI I INTEGRITETIT 2023-2025

5	Moskryerja e analizës së nevojave për trajnime	Veprimtaria	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i metodologjisë së vlerësimit vjetor për trajnimet si dhe për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve tek punonjësit. 2. Kryerja e vlerësimit vjetor të nevojave për trajnime	Përgjegjësit e çdo sektori, Menaxheri i Cilësisë, Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Financës. Gjashtëmujori i dytë, 2024
6	Njohuri të kufizuara të punonjësve për rregullat e etikës. Mungesa e komisionit disiplinor në zbatim të kodit të etikës së institucionit.	Veprimtaria/ Reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	1. Organizimi i trajnimeve nga Sektori i Burimeve Njerëzore me qëllim njohjen e stafit me Kodin e Etikës. 2. Pjesëmarrja e stafit në trajnimet e organizuara nga ASPA apo donatorë të ndryshëm për etikën dhe integritetin. 3. Ngritja e komisionit disiplinor në zbatim të kodit të etikës.	Sektori i Burimeve Njerëzore. Gjashtëmujori i parë i 2024 e në vazhdimësi
OBJEKTIVI 2: RRIJTJA E TRANSPARENCËS NË NDARJEN E INFORMACIONEVE ME PUBLIKUN					
1	Mos përditësimi i vazhdueshëm i website zyrtar të QKTGJ	Reputacioni dhe imazhi i institucionit	I ulët	1. Përditësimi i faqes zyrtare qktgj.gov.al, dhe mirëmbajtje e rrjeteve sociale nga persona të caktuar. 2. Pjesëmarrja e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, në trajnimet e organizuara nga ASPA.	Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik. Punonjësit përgjegjës për menaxhimin e rrjeteve sociale. Tremujori i katërt 2023 e në vazhdimësi

PLANI I INTEGRITETIT 2023-2025

2	Njohuri të kufizuara të punonjësve për rregullat e komunikimit brenda institucionit	Veprimtaria	I ulët	1. Informim periodik për rregullat e komunikimit, formatet e komunikimit dhe etikën e komunikimit	Sektori i burimeve njerëzore. Në vijimësi
OBJEKTIVI NR.3: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË RUAJTJES SË DOKUMENTACIONIT DHE I ARKIVËS					
1	Mosfeksionimi i sistemit digjital të protokollit.	Veprimtaria/ Teknologjia dhe Imazhi	I lartë	1. Ndërtimi i një sistemi të ri digjital të protokollit.	Grup pune ngritur me urdhër të Titullarit, Sektori i Administratës, AKSHI. Gjashtëmuji i dytë i 2024 e në vazhdimësi
2	Arkiva digjitale nuk është tërësisht funksionale.	Veprimtaria	Mesatar	1. Përditësimi i pajisjeve dhe softuerit të arkivës digjitale.	Grup pune ngritur me urdhër të Titullarit, Sektori i Administratës, AKSHI. Gjashtëmuji i parë i 2025 e në vazhdimësi
3	Ngarkesë pune në njësinë e Sekretarisë/Protokollit/Arkivimit. Burime njerëzore të pamjaftueshme për proceset e digjitalizimit të protokollit dhe arkivës.	Veprimtaria	Mesatar	1. Të vlerësohet ngarkesa e punës së kësaj njësie dhe mundësia e ndarjes së punës me sektorë të tjerë. 2. Analiza t'i komunikohet Titullarit të institucionit 3. Të vlerësohet struktura aktuale për pajisjen me kapacitete shtese për realizimin e proceseve të digjitalizimit.	Grup pune me punonjës të administratës. Gjashtëmuji i parë i 2024
OBJEKTIVI NR. 4: PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT, TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES NË SEKTORIN MJEKËSOR TË QKTGJ					
1	Mungesa e procedurave standarde të punës të reja apo të përditësuara	Veprimtaria	I lartë	Hartimi i POS të reja dhe rishikimi i POS ekzistuese	Menaxheri i Cilësisë, Sektorët mjekësorë të QKTGJ. Tremujori i parë i 2024

PLANI I INTEGRITETIT 2023-2025

2	Mungesa e procedurave standarde të punës ne rastet e inspektimeve/ auditimeve të shërbimit të transfuzionit në bankat e gjakut dhe spitalet publike e jo publike që përdorin gjak e komponentë	Veprimtaria	I lartë	Hartimi i POS për inspektimet	Grup pune i ngritur me urdhër të Titullarit, Nëndrejtori Teknik, Menaxher i Cilësisë. Tremujori i parë i 2024
3	Vonesa në realizimin e auditimeve/inspektimeve në shërbimin e transfuzionit në bankat e gjakut dhe spitaleve që përdorin gjak e komponentë	Veprimtaria	I lartë	1. Realizmi në kohë i kontrolleve me grupe pune të posaçme të miratuar nga titullari. 2. Hartimi dhe miratimi nga titullari i një plani paraprak auditimesh.	Grupe pune të ngritur me urdhër të Titullarit, Nëndrejtori Teknik, Menaxher i Cilësisë. Gjashtëmujori i parë i 2024 dhe në vijimësi sipas një plani të mirë përcaktuar
OBJEKTIVI NR.5: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR					
1	Gjurmët e auditit për proceset e punës në Sektorin e Financës nuk janë të përditësuara.	Veprimtaria/Financiare	Mesatar	1. Të rishikohen gjurmët e auditit për proceset e punës që kryen Sektori i Financës	Sektori i Financës. Gjashtëmujori i parë i 2024
2	Përmirësim i planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit	Veprimtaria/Financiare	Mesatar	1. Rritja e kontrollit të brendshëm dhe drejtimi i vazhdueshëm dhe korrekt i proceseve të menaxhimit financiar, por dhe të shpenzimit të shumave të alokuara.	Sektori i Financës. Në vijimësi